



Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të BMP për të marrë vendime

Bordi i Mbikëqyrjes Publike është organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë jopraktikues të cilët e ushtrojnë veprimtarin e tij në zbatim të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, të Statutit të miratuar dhe VKM 789, datë 9.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të bordit të mbikëqyrjes publike” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Procedura që ndjek BMP për marrjen e vendimeve është si më poshtë vijon:

- a) Bordi i Mbikëqyrjes Publike ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në bazë të Ligjit, nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve të tij dhe marrjes së vendimeve në përputhje me procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike të përcaktuara në Ligj dhe në VKM nr. 786 datë 9.11.2016. Mbledhjet e bordit zhvillohen në vendin e përcaktuar në shkresën e thirrjes. Bordi, si rregull, zhvillon një mbledhje në muaj, por mund të mbledhet sa herë që ka çështje të rëndësishme, që duhet të shqyrtohen.
- b) Thirrja e mbledhjes bëhet nga kryetari i bordit, i cili vendos datën, rendin e ditës dhe orën. Në mungesë të tij vetëm me miratim dhe porosi të nënshkruar të kryetarit, mbledhja mund të thirret nga anëtari më i vjetër në detyrë dhe, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë.
- c) Si rregull i përgjithshëm Bordi i Mbikëqyrjes Publike nuk mund të mbledhet pa prezencën e Kryetarit.
- d) Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e bordit, kur kjo kërkohet me shkrim nga, të paktën, 1/3 e anëtarëve, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjes, në këtë rast, bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve pune pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve dhe, të paktën, brenda 5 (pesë) ditëve pune para datës së caktuar për mbledhje.
- e) Mbledhja drejtohet nga kryetari i Bordit. Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve së bashku me prezencën e kryetarit. Në rastin kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve ose kryetari mbledhja shtyhet për një ditë tjetër. Kryetari vendos thirrjen e saj në një ditë tjetër, jo më afër se 24 (njëzet e katër) orë pas mbledhjes së anuluar. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

rast barazie votash, vota e kryetarit është vendimtare. Bordi merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.

f) Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Ato duhet të jenë të argumentuara dhe, në çdo rast, vendimet kundër duhet të shpjegohen.

g) Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, me shkrim, i cili përmban një përmbledhje të të gjithë procesit, por pa u kufizuar në opinione të anëtarëve, të dhëna për datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, arsyetimin, vendimet që u morën, si dhe rezultatin e votimeve. Procesverbali mbahet nga struktura mbështetëse e bordit dhe duhet të paraqitet për nënshkrim të të gjithë anëtarët në përfundim të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.

h) Bordi i Mbikëqyrjes Publike, miraton me jo më pak se tre vota pro të anëtarëve të tij, ndryshimet e Statutit.

i) Anëtari i Bordit të Mbikëqyrjes Publike ka të drejtën e një vote, vetëm kur është i pranishëm personalisht në mbledhje. Si përjashtim nga ky rregull, në raste të veçantë, urgjente e tepër të rëndësishme, Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton vendime edhe pa u mbledhur, nëpërmjet votimit me shkrim dhe dërgimit të votës përmes mjeteve të sigurta të komunikimit të teknologjisë së informacionit (vendime qarkulluese).